
THE USE OF THE TEXT IN THE FOREIGN LANGUAGE DIDACTICS

Aterda Lika

University of Shkodra, Foreign languages faculty, Romanistic department, aterda.lika@unishk.edu.al

Lindita Kazazi

University of Shkodra, Foreign languages faculty, Romanistic department, lindita.kazazi@unishk.edu.al

Abstract: In the didactics of the foreign language, the notion of text is very important as it favors success in language teaching. All the linguistic-communicative contents are based on a wide array of texts that will have to respond to the needs of the students.

Our work presents the importance of choosing the texts in the didactic of the Italian language, focusing on the concept of the text, the presentation of the various types of text also analyzing the various criterians of textuality.

Analyzing the characteristics of the texts in the didactic field our contribution underlines the analysis of the learners' needs which leads us to consider the various texts to be used in a language course.

Some important considerations in this context are the nature of the learner, his age, his culture of origin, the training needs and his linguistic and communicative competence. The focus is also on the analysis of the texts that we find in some Italian books that are used in our schools and in our language courses.

Keywords: text, foreign language, teaching

PËRDORIMI I TEKSTIT NË DIDAKTIKËN E GJUHËS SË HUAJ

Aterda Lika

University of Shkodra, Foreign languages faculty, Romanistic department, aterda.lika@unishk.edu.al

Lindita Kazazi

University of Shkodra, Foreign languages faculty, Romanistic department, lindita.kazazi@unishk.edu.al

Abstrakt: Në didaktikën e gjuhëve të huaja koncepti i tekstit është shumë i rëndësishëm meqenëse i shërben arritjes së suksesit në mësimin e gjuhës. E gjithë përmbajtja gjuhësore komunikative mbështetet në një rrjet të gjerë tekstesh që duhet t'i përgjigjen nevojave të nxënësve. Punimi ynë synon të paraqesë rëndësinë e zgjidhjes së tekstit në didaktikën e gjuhës italiane, duke u ndalur tek koncepti i tekstit, paraqitja e llojeve të ndryshme të teksteve duke analizuar edhe kriteret e ndryshme të testualitetit. Duke analizuar karakteristikat e teksteve nga pikëpamja didaktike, kontributi ynë ndalet tek domosdoshmëria e analizës së nevojave të nxënësve me qëllim zgjedhjen e teksteve që duhen përdorur në një kurs gjuhe. Disa elementë të rëndësishëm për t'u konsideruar janë: lloji i nxënësit, moshja e tij, kultura e origjinës së tij, nevojat e tij formative si dhe aftësitë e tij gjuhësore. Fokusi ynë, gjithashtu vendoset edhe në analizën e teksteve që gjejmë në disa metoda të gjuhës italiane që përdoren në shkollat tona dhe në kurset e ndryshme të gjuhës.

Fjalë kyçe: tekst, gjuhë e huaj, mësimdhënie

Përgjithësisht në mësimin e një gjuhe të huaj detyrë kryesore e mësuesit është të sigurojë një mësimdhënie të suksesshme duke iu përgjigjur nevojave të ndryshme të nxënësve. Gjatë përvojës sonë shpesh kemi vënë re që, për arsye të ndryshme që lidhen me kushtet ekonomike, administrative dhe organizative, mësimi i gjuhës së huaj bazohet në një metodologji të konceptimit të sillabuseve me përmbajtje relativisht të përgjithshme që përlligjet nga synimi për t'i ofruar nxënësve aftësitë e përgjithshme në gjuhën italiane të cilat e mundësojnë të përdorë gjuhën dhe të bashkëveprojë në kontekste të ndryshme.

Siç theksohet edhe në dokumentet e Këshillit të Evropës, detyrë e mësuesve është të përshtatin mësimdhënien në mënyrë të tillë që gjuhët të shërbejnë si mjet i rritjes dhe formimit të individëve të konceptuar si “aktorë socialë” të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur nëshkëmbimet e ndryshme shoqërore.

Për realizimin e këtyre objektivave duhet që elementët gjuhësorë dhe komunikativë të gjuhës së huaj të bazohen në një rrjet tekstesh të ndryshëm të pranishëm në metodat e gjuhëve. Në lidhje me këtë çështje është i vlefshëm studimi i i Dario Corno, i cili thekson se “ koncepti i tekstit nuk është vetëm thelbësor në didaktikë, por është vendimtar për të përgatitur programe që garantojnë një mësimnxënie të suksesshme.”(Desideri 1991:46)

Sipas kriterëve që përcakton gjuhësia e tekstit, me tekst kuptojmë tërësinë e fjalëve, fjalive dhe paragrafëve që lidhen sipas qëllimit, kuptimit dhe saktësisë gramatikore. Elementët kryesorë të një teksti janë koherenca, e cila është lidhja logjike e një teksti dhe kohezioni që lidhet me tërësinë e mjeteve gjuhësore në funksion të koherencës.

Në bazë të funksionit komunikues mund të dallojmë tekste me funksion praktik dhe me funksion estetik. Ndër tekstet me funksion praktik zënë vend tekstet joletrare të cilët mund të jenë rrëfyes, përshkrues, paraqitës, argumentues, ndërsa ndër tekstet me funksion estetik gjejmë tekstet letrare, të cilat mund të jenë tregimtarë, poetikë e dramatikë.

Tekstet jo letrare:

Teksti rrëfyes tregon ngjarje reale me personazhe dhe vende reale dhe ka për synim të nxisë fantazinë e lexuesit. Mund të jenë kronikat, shënimet e udhëtimit, biografite intervistat etj.

Teksti përshkrues përshkruan karakteristikat e njerëzve, kafshëve, sendeve, vendeve, objekteve dhe synon të përshkruajë cilësi fizike e psikologjike që lexuesi i percepton mendërisht. Mund të jenë guidat, traktatet teknike, tekstet shkencore etj.

Teksti paraqitës paraqet të dhëna, informacione, shpjegon koncepte, teori mbi një argument të caktuar dhe synon të shpjegojë, të sqarojë a të ilustrojë një teori. Mund të jenë njoftimet, zërat e enciklopedive, përmbledhjet etj.

Teksti argumentues mbështet opinione, teza, vlerëson fakte, gjëra, persona. Ka për qëllim të bindë lexuesin për vlefshmërinë e tezës dhe të gjykimin të vet. Mund të jenë ese, artikuj politikë e propagandistikë etj.

Teksti udhëzues jep udhëzime, këshilla, urdhra dhe synon të udhëzisë, këshillojë, detyrojë, urdhërojë lexuesin që të ndjekë një qëndrim ose të kryejë veprime sipas një radhe të caktuar. Mund të jenë ligjet, vendimet, udhëzimet, urdhrat, recetat, udhëzuesit e përdorimit etj.

Tekstet me funksion estetik- tekstet letrare.

Teksti rrëfyes ose narrativ rrëfen për ngjarje a personazhe reale ose të trilluara dhe ndërtohet sipas një strukture artistike. Synon të pasqyrojë jetën nëpërmjet figurave artistike dhe të shkaktojë përjetime e emocione të caktuara tek lexuesi. Mund të jenë legjendat, romanet, novelat, tregimet etj.

Teksti poetik rrëfen për ngjarje ose personazhe nëpërmjet vargjeve dhe organizimeve të ndryshme tingullore, shpreh ndjenja e emocione nëpërmjet gjuhës së figurshme. Synon të ndikojë thellë në mendjen, në zemrën e në ndjenjat e lexuesit, duke shfrytëzuar mjetet shprehëse të gjuhës. Mund të jenë poemat epike, eposi, ciklet e këngëve, poezia etj.

Teksti dramatik rrëfen nëpërmjet personazheve veprues dhe lojës së aktorëve në skenë. Synon të pasqyrojë jetën nëpërmjet gjuhës skenike (dialogëve dhe monologëve) dhe të shkaktojë përjetime dhe emocione të caktuara te shikuesi. Mund të jenë tragjedia, komedia, drama, farsa etj.

Bazuar në studimin e Vedovelli-t (Vedovelli 2002: 85) kujtojmë se “përshkrimi, rrëfimi, dhe argumentimi janë tri kategoritë tipologjike themelore që konsiderohen të tilla në morinë e teorive dhe modeleve të analizës së tekstit. Këto kategori paraqiten si universale apo të përgjithshme, të pranishme në çdo kod gjuhësor.”

Mësuesi i gjuhës, të cilit i intereson më së shumti realiteti komunikativ, është i ndërgjegjshëm që tipet e përgjithshme të teksteve konkretizohen në metodat e gjuhëve të huaja sipas llojeve të ndryshme të teksteve që përfshijnë tregimet, njoftimet, një mesazh telefonik, një email, një poezi e këto janë burime të pashtershme mbi të cilat mund të bazohet procesi i mësimdhënies.

Nga pikëpamja e mësimdhënies së gjuhës së huaj ne na intereson ta shohim tekstin si një produkt komunikativ që i drejtohet një marrësi bazuar në një situatë të caktuar.

Në Kuadrin e Përbashkët të Referencave për gjuhët me “tekst nënkuptohet çdo sekuencë e ligjërimit gojor ose të shkruar që përdoruesit/nxënësit marrin, prodhojnë ose shkëmbejnë. Për rrjedhojë, nuk do të kishte akt komunikimi gjuhësor pa tekst” (KERGJ 2006: 72)

Në rastin e përzgjedhjes së teksteve për mësimin e gjuhës së huaj duhen patur parasysh edhe nxënësit, nëse ata do të jenë në gjendje të asimilojnë tekstet e propozuara. Për një mësimdhënie efektive duhen konsideruar disa elementë që bazohen tek nxënësi, mosha e tij, kultura e origjinës së tij, nevojat e tij formative si dhe aftësitë e tij gjuhësore.

Bazuar edhe në sugjerimet e Kuadrin Evropian të Referencave, një tekst, që të përdoret për qëllime didaktike duhet të ketë disa karakteristika të caktuara si p.sh: duhet patur parasysh që teksti të jetë interesant dhe i dobishëm në mënyrë të tillë që të mbajë gjallë gjallë motivimin e nxënësit, duhet bërë kujdes në respektimin e karakteristikave gjuhësore që lidhen me tërësinë dhe kuptueshmërinë të cilat duhet të përshtaten me aftësitë e nxënësit, si dhe të sigurohet paraqitja fizike e tekstit që do të thotë që duhet t'i përmbahet nivelit të mjaftueshëm të qartësisë dëgjimore dhe pamore.

Në varësi edhe të zhvillimit teknologjik sot në didaktikën e gjuhëve të huaja përdoret një shumëllojshmëri e prezantimit të teksteve të cilët mund të jenë tekste të shkruara në letër, tekste bazuar në materiale audio, tekste bazuar në materiale video si dhe materiale të ndryshme multimediale.

Tekstet e paraqitura si materiale në letër janë më të përhapurit dhe më të përdorshmit nga mësuesit. Mund të përmendim këtu tekstet letrare, reklama revistash apo gazetash, fletëpalosje, artikuj gazetash, harta gjeografike, receta kuzhine etj. Këta tekste konsiderohen si më fleksibël, sepse mund të përdoren në shumë mënyra dhe mund edhe të fotokopjohen.

Tekstet e paraqitura nëpërmjet materialeve audio paraqesin edhe avantazhe të tjera, sepse dëgjimi injë tregimi p.sh. mund të konsiderohet si një shkëmbim mes dy personave, pasi nuk është gjithmonë pasiv, por mund të shërbejë për të stimuluar imagjinatën dhe krijimtarinë e dëgjuesit e mund të shfrytëzohet shumë mirë si një mjet kreativ didaktik. Na vijnë në ndihmë nga ky aspekt programet në radio, reklamat radiofonike, këngët, dialogjet, intervistat, audiolibrat.

Tekstet nëpërmjet materialeve video mund të jenë programe televizive të llojeve të ndryshme (talk show sociale e politike, dokumentarë, edicione lajmesh, parashikime moti, lojra, kuice televizive, kronika sportive), filma. Këta materiale paraqesin një gamë të gjerë shembujsh gjuhësorë si regjistra të ndryshëm, dialekte, stile të folurit që sjellin situata të vlefshme mësimore dhe ndimojnë në përvetësimin e një aftësie të mirë komunikuese, sepse e paraqesin gjuhën sipas konteksteve të ndryshme. Gjithashtu përdorimi i pamjeve e përmirëson kuptimin e mesazhit gjuhësor bazuar tek xhestet, lëvizjet e trupit, veshjet, natyrisht kur aktorët e videos janë italianë të vërtetë.

Tekstet e paraqitur si materiale multimediale në të cilët përfshihen të gjithë materialet e përdorshme të shkarkuara nga interneti, si video, audio apo vetëm leximi, posta elektronike, bisedave online, apo edhe videokonferencat nëpërmjet kamerave me persona që e kanë gjuhë amtare i mundësojnë nxënësve të huaj të vihen në kontakt me tekste që konsiderohen si materiale autentike.

Një problematikë tjetër në përzgjedhjen e teksteve për qëllime didaktike lidhet edhe me përzgjedhjen e teksteve autentike. Edhe pse për vite me radhë në metodologjinë e gjuhëve të huaja janë theksuar efektet pozitive që sillte përdorimi i teksteve autentike ka një debat akoma të hapur rreth kësaj çështjeje. Megjithatë një didaktikë e ndërmjetme e drejtuar nga ana e mësuesit ekuilibron më së miri pozicionet e ndryshme të kritikëve duke nxjerrë në pah avantazhet e pamohueshme të përdorimit të tij në didaktikë. Në propozimet e dokumenteve evropiane edhe teksti autentik përfshihet në universin e tekstualitetit. Kjo do të thotë që kriteri i përzgjedhjes së tekstit autentik nuk paraqet më një element diskriminues për të vlerësuar glotodidaktikën si të mirë apo të keqe. Është organizimi i karakteristikave të tekstualitetit që çdo tekst përmban që siguron cilësinë. Gjatë procesit mësimor nxënësit e preferojnë përdorimin e materialeve autentike. Shpesh herë propozimet e mësuesit për përdorimin e teksteve autentike priten me kënaqësi, sepse për nxënësit që e mësojnë gjuhën si gjuhë e dytë konsiderohet si një rast për t'u vënë në provë me një lloj komunikimi që mund ta ndeshin në jetën e përditshme, ndërsa për nxënësit që e mësojnë si gjuhë të huaj përbën mundësinë për t'u përballur me një gjuhë reale. Nëse i referohemi përpilimit të sillabusit tekstual të një kursi gjuhe duhet theksuar se zakonisht në nivelet e para të mësimnxënies (A1,A2) zënë vend kryesisht tekste gojore dhe me figura të cilët gërshetohen me tekste të thjeshta gojore apo të shkruara, shpeshherë edhe të përshtatura. Në vazhden e zhvillimit ndërgjuhësor të nxënësve shtohen tekste gojorë e të shkruar gjithnjë e më kompleksë nga pikëpamja e përmbajtjes gjuhësore duke iu referuar karakteristikave kulturore,

krijuese, tekstuale, leksikore e morfosintaksore të një teksti, në fillim në nivelin B1 bazuar në italishten e përgjithshme e më tej në B2, C1 e C2 në nivelin e italishtes së letërsisë apo atë të ligjërimeve sektoriale. (Balboni 2008: 213) Duke punuar për ndërtimin e një sillabusi tekstual për t'u përdorur në mësimdhënien e gjuhës së huaj mësuesi duhet gjithnjë të ketë parasysh disa kritere për përzgjedhjen e teksteve duke vlerësuar elementë të tillë si:

Përbërja gjuhësore. Duhet zgjedhur tekste të pasur nga pikëpamja gjuhësore, por edhe të përshtatshëm me aftësitë e nxënësve, duhet që edhe karakteristikat gjuhësore të përputhen me funksionin e dyfishtë që duhet të ketë organizimi i tekstit në mësimnxënie/mësimdhënie; të bëjë të mundur ndërveprimin shoqëror dhe të zhvillojë aftësitë e nxënësit.

Tipologjia e teksteve. Një tekst duhet zgjedhur duke u bazuar edhe në karakteristikat e tij tipologjike. Karakteristikat tipologjike më të konsiderueshme nga pikëpamja didaktike janë tekstet narrative, përshkrues e argumentativ të cilët konsiderohen edhe makrofunksione.

Në çdo lloj gjuhe gjejmë tekste që bëjnë pjesë në këtë kategori, prandaj çdo folës mund t'ireferohet këtij klasifikimi. Strukturimi i ligjeratës. Rregullat e brendshme strukturore të një teksti të caktuar. Kohezioni dhe koherenca. Koherenca nga pikëpamja e përmbajtjes dhe kohezioni në lidhjet formale që vendosen ndërmjet pjesëve.

Dallimi nëmjet teksteve të shkruar a gojorë. Në tekstet gojorë informacioni ndodh në kohë reale ose në një kohë shumë të shkurtër aq sa mund të duhet kohë për ta përpunuar dhe shprehur. Në këtë rast ndërhyrjet nga gjuha e parë ose devijimet mund ta rritin shkallën e vështirësisë.

Gjatësia e tekstit. Një tekst i gjatë kërkon një kohë më të gjatë përpunimi, një impenjim më të madh të kapacitetit të trurit dhe ekziston edhe rreziku i hutimit.

Rëndësia për nxënësin. Duhet zgjedhur tekstet në mënyrë të tillë që nxënësi të jetë i motivuar në varësi edhe të nevojave të tij, sepse motivimi varet edhe nga interesat personale të gjithsecilit.

Në përfundim mund të themi se si mësuesi ashtu edhe nxënësi të gjendur përballë tekstit duhet të jenë të vetëdijshëm që teksti është një proces, një stimul që të udhëheq drejt të kuptuarit. Kontakti me tekstin është një përvojë formuese dhe motivuese, sepse lexuesi nuk është thjeshtë një marrës i mesazhit, por edhe interpretues i përmbajtjes së tekstit, dhe siç shprehet Umberto Eco leximi është një aktivitet i llojit bashkëpunues (Eco : 1979). Nëpërmjet tekstit nxënësi

zbulon dhe sheh realitetin. Puna me tekste të përshtatshme qofshin autentikë ose jo i ndihmon nxënësit të marrin një përvojë gjithëpërfshirëse gjuhësore që zgjeron në mënyrë të vazhdueshme sistemin e tyre ndërgjuhësor në gjuhën e huaj.

REFERENCA

Balboni P. E. (2008), *Imparare le lingue straniere*, VENEZIA, Marsilio

Bettoni C. (2002), *Imparare un'altra lingua*, Bari, Laterza

Desideri P. (nën kujdesin e), (1991) *La centralità del testo nelle pratiche didattiche*, Quaderni del Giscel, La Nuova Italia, Firenze,

Diadori, P. (nën kujdesin e) (2019) *Insegnare italiano a stranieri*, Mondadori education, Milano

Eco, U. (1979), *Lector in fabula*, Bompiani, Milano

Këshilli i Evropës (2006) *Kuadri i Përbashkët evropian i referencave për gjuhët: Të nxënit, Të mësuarit, vlerësimi*. Filara

Lo Duca M.G. (2006), *Sillabo di italiano L2*, Carocci, Roma

Vedovelli M. (2002), *Guida all'italiano per stranieri. La prospettiva del Quadro comune europeo per le lingue*, Roma, Carocci